



Shqipëria në rrugën
e integrimit evropian



Çfarë është Bashkimi Evropian?

Bashkimi Evropian (BE) është një organizatë ndërkombëtare e një lloji të veçantë [*sui generis*]. BE është bashkimi politik i 27 shteteve anëtare të cilat qeverisin sëbashku:

- ★ Politikat ekonomike,
- ★ Politikat e sigurisë; dhe
- ★ Politikat sociale.

BE-ja [dikur Komuniteti Evropian i Qymyrit dhe Çelikut] u krijua në 9 maj 1950 pas deklaratës së Ministrit të Jashtëm francez Robert Schumann, i cili propozoi idenë e një Evrope federale, e cila mund të krijohej vetëm përmes bashkimit ekonomik.



Si funksionon Bashkimi Evropian?

Bashkimi Evropian funksionon mbi bazë të kompetencave që shtetet anëtare i kanë transferuar Unionit. Këto kompetenca ndahen në disa kategori në bazë të politikës, që ato mbulojnë.

Kompetencat ekskluzive – janë politikat për të cilat vetëm BE mund të hartojë dhe të miratojë ligje, duke rregulluar të gjithë veprimtarinë në këto fusha. Shtetet anëtare ja kanë transferuar të gjithë fuqinë e tyre të këtyre fushave Unionit. BE-ja vepron e pavarur duke mos pasur detyrim të marrë miratimin e Shteteve Anëtare për të rregulluar veprimtarinë në këto fusha.

Doganat, rregullat e konkurrencës, politika monetare për eurozonën, politika tregtare, mbrojtja e marinës biologjike, nënshkrimi marrëveshjeve ndërkombëtare në emër të Bashkimit Evropian.



Kompetencat e përbashkëta – këto kompetenca përfshijnë politika ku BE-ja dhe Shtetet Anëtare kanë të drejtë të miratojnë ligje të detyrueshme për rregullimin e këtyre fushave. Shtetet Anëtare miratojnë ligje dhe drejtojnë këto kompetenca në ato sektorë ku BE-ja nuk ka miratuar akte rregulluese.

Tregu i përbashkët, politika sociale, agrikultura, mjedisi, mbrojtja e konsumatorit, transporti, energjia, liria-siguria-drejtësia, bashkëpunimi për zhvillim, politika e jashtme-mbrojtjes dhe sigurisë etj.

Kompetencat mbështetëse – janë ato politika për të cilat BE-ja mund të ndërhyjë vetëm në mbështetje, koordinim ose plotësim të masave që kanë marrë vetë Shtetet Anëtare. Nga pikëpamja ligjore aktet e miratuara nga BE-ja në këto sektorë nuk kanë nevojë për t'u harmonizuar me legjislacionet e Shteteve Anëtare.

*Shëndeti, industria, edukimi,
arsimi profesional, rinia, sporti,
kultura, mbrojtja civile etj.*

Kompetencat e veçanta – Bashkimi Evropian mund të marrë masa për të garantuar se Shtetet Anëtare koordinojnë politikat e tyre ekonomike, sociale dhe të punësimit në nivel Unioni.

Politika e përbashkët për marrëdhëniet me jashtë dhe sigurinë karakterizohet nga tipare specifike institucionale sikurse është pjesëmarrja e kufizuar e Parlamentit dhe Komisionit Evropian në procesin vendimmarrës dhe përjashtimi nga proceset legjislative. Kjo fushë e politikës përcaktohet nga Këshilli Evropian, i cili përbëhet nga një përfaqësues për secilin shtet anëtar.

Presidenti i Këshillit Evropian dhe përfaqësuesi për Punët e Jashtme dhe Sigurinë përfaqësojnë BE-në në nivel ndërkombëtar për çështje që lidhen me politikën e jashtme dhe sigurinë.

BE-ja i ushtron kompetencat e saj në bazë të dy parimeve tepër të rëndësishme:

Parimi i proporcionalitetit – përmbajtja dhe ndërhyrja e BE nuk mund të shkojnë përtej asaj çfarë është e domosdoshme të miratohet për të përmbushur objektivat e traktateve.

Parimi i subsidiaritetit – në fushat e kompetencave jo ekskluzive BE-ja vepron vetëm dhe për aq sa objektivi i veprimtarisë në fjalë nuk arrihet mjaftueshëm nga Shtetet Anëtare, por mund të adresohet më mirë në nivel Unioni.



Institucionet e Bashkimit Evropian

Parlamenti Evropian është zëri i qytetarëve të BE, ku eurodeputetët zgjidhen drejtpërdrejtë nga qytetarët e Shteteve Anëtare. Parlamenti aktualisht ka 720 deputetë dhe 8 grupe politike, ku secili grup përbëhet nga të paktën 25 anëtarë me përfaqësues nga të paktën 25% e vendeve anëtare. Numri i eurodeputetëve për secilin shtet ndahet në bazë të numrit të popullsisë së shtetit. Megjithatë, Parlamenti ka dhe një numër minimal eurodeputetësh për shtetet e vogla p.sh. Luksemburgu me 6 eurodeputetë. Ky numër minimal ka krijuar shpesh debate duke u quajtur një diskriminim për Shtetet Anëtare me numër popullsie më të madhe p.sh. Gjermania e cila ka 96 eurodeputetë. Funksioni kryesor i Parlamentit është bashkë-ligjvënja, funksion ky i cili ndahet me Këshillin Evropian dhe Komisionin.

Komisioni Evropian është një nga tre institucionet kryesore të BE dhe përbëhet nga 27 komisionerë, një nga secili vend anëtar. Komisionerët propozohen nga Këshilli dhe përbërja e Komisionit miratohet nga Parlamenti Evropian. Megjithatë, komisionerët e ushtrojnë mandatin

e tyre 5 vejçar në mënyrë të pavarur dhe nuk mbrojnë interesin e shtetit të tyre të origjinës, por interesin e përbashkët të Bashkimit Evropian. Secili komisioner mbulon një fushë kompetence.

Këshilli i Bashkimit Evropian ose Këshilli i Ministrave është një ndër organet kryesore vendimmarrëse të BE-së. Ai përbëhet nga një ministër nga secili shtet/secila qeveri, ku pjesëmarrja varet nga fusha e çështjeve që trajtohen. Funksionet kryesore të Këshillit janë bashkë-ligjvënia [me Parlamentin dhe Komisionin], bashkërendimi i politikave ekonomike, nënshkrimi i marrëveshjeve ndërkombëtare në emër të BE-së [përfaqësimi i BE-së], bashkë-miratimi i buxhetit të BE-së [bashkë me Parlamentin], si dhe përmirësimi i politikës së përbashkët të marrëdhënieve me jashtë dhe sigurisë.

Këshilli Evropian është një institucion i “zyrtarizuar” me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës (2009), i cili është një forum me përbërje të të gjithë liderve të shteteve anëtare [krerëve të shteteve]. Këshilli, i cili mbledhet 4 herë në vit, vendos prioritetet kryesore politike për BE-në. Presidenca e Këshillit lëviz me rotacion mes shteteve anëtare dhe ndryshon çdo 6 muaj dhe kjo presidencë përfaqësohet nga qeveria e shtetit anëtar në tërësi dhe jo nga një individ i vetëm.

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian është shkalla më e lartë e gjyqësorit në BE dhe vepron si gjykatë ndërkombëtare. Gjykata njihet ndryshe si



“roja e Traktateve” dhe garanton që e drejta e BE-së të interpretohet dhe zbatohet në mënyrë të njëjtë në të gjitha shtetet, si dhe të zbatohet nën frymën e Traktateve. Gjykata ka numër të njëjtë gjyqtarësh me numrin e shteteve anëtare, ku secili prej tyre vepron i pavarur nga interesi i shtetit nga ka origjinën.

Banka Qendrore Evropiane është institucioni përgjegjës për politikën monetare për të gjithë vendet anëtare të BE-së që përdorin euro. Qëllimi kryesor i Bankës është garantimi i stabilitetit të çmimeve në eurozonë. Detyrat qendrore janë përcaktimi dhe zbatimi i politikës monetare në shtetet e Bashkimit Monetar Evropian (BME), administrimi i rezervave valutore zyrtare, emetimi i monedhës “euro”, mbështetja e sistemit të pagesave dhe zbatimi i transaksioneve valutore.





Zgjerimi i BE-së me Ballkanin Perëndimor

Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë nisur rrugëtimin e tyre zyrtar për anëtarësim në BE, me nënshkrimin e Marrëveshjeve të Stabilizim Asociimit. Rrugëtimi i këtyre shteteve ka kaluar përmes progresit, sfidave por edhe qëndrimit në situata konstante. Megjithatë, një pjesë e shteteve të Ballkanit skanë qenë kurrë më afër BE-së se sa pas nisjes së luftës në Ukrainë në shkurt të 2022.

Presidentja e Komisionit Evropian në deklaratën e saj vjetore përpara Parlamentit Evropian u shpreh se BE-ja nuk mund të jetë tërësisht e plotësuar pa Ballkanin Perëndimor.

Megjithatë, kushtet e Unionit për avancimin më tej drejt procesit të zgjerimit lidhen me disa aspekte kyçe. Më konkretisht, shtetet e Ballkanit duhet të angazhohen më tepër në **forcimin e demokracisë dhe respektimin e të drejtave të njeriut**. Gjithashtu, të 6 shtetet e rajonit duhet të **përmirësojnë marrëdhëniet e fqinjësisë** së mirë dhe të ulin tensionet e krijuara ndër vite mes njëri-tjetrit.

Një kriter tjetër i përbashkët për të gjithë shtetet e Ballkanit është dhe angazhimi i tyre në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, një fenomen ky i përhapur në secilin shtet pavarësisht dinamikave të tyre lokale.

Prej vitit 2020, BE-ja është duke zbatuar **një metodologji të re zgjerimi**, e cila ka **grupuar të gjithë kapitujt e negociatave** për anëtarësim në grupe, njohur ndryshe si **“clusters”**. Në vijim do të japim një shpjegim të përmbledhur për secilin grup.

Grupkapitulli 1 - Themeloret- është grupkapitulli më i rëndësishëm i të gjithë negociatave për anëtarësim. Ky grup përfshin gjyqësorin, drejtësinë, të drejtat themelore, lirinë, sigurinë, kontrollin financiar, prokurimet publike dhe statistikat. Gjatë procesit negociues ky grup hapet i pari dhe mbyllet i fundit, duke përcaktuar të gjithë progresin e negociatave.

Grupkapitulli 2 - Tregu i brendshëm – përfshin negociatat për katër liritë brenda BE-së: lëvizjen e lirë të mallrave, punonjësve, shërbimeve dhe kapitalit. Ky grup përfshin legjislacionin në fushën e korporatave, pronësinë intelektuale, politikat e konkurrencës, shërbimet financiare dhe mbrotjen e konsumatorit dhe shëndetit.

Grupkapitulli 3 - Konkurenca dhe rritja gjithëpërfshirëse – përmban të gjithë kuadrin negociues që fokusohet në shoqërinë e informacionit, median, taksa, ekonominë dhe politikën monetare, politikat sociale, punësimin, politikat

industriale, sipërmarrjet, shkenca, kërkimi edukimi, kultura dhe doganat.

Grupkapitulli 4 – Agjenda e gjelbër dhe ndërlidhja e qëndrueshme – ky grup fokusohet në politikat e transportit, energjisë, rrjetit trans-evropian, mjedisi dhe ndryshimet klimatike.

Grupkapitulli 5 – Burimet, bujqësia dhe kohezioni – përfshin të gjithë kuadrin negociues mbi bujqësinë, zhvillimin rural, sigurinë ushqimore, veterinarinë, politikat fitosanitare, peshkimin, politikat rajonale dhe parashikimet financiare e buxhetore.

Grupkapitulli 6 – Marrëdhëniet me jashtë – në këtë grup përfshihet politika e përbashkët e BE-së për tregëtinë, ndihmat humanitare, bashkëpunimin për zhvillim, si dhe politika e përbashkët për marrëdhëniet me jashtë dhe sigurinë.

BE-ja është duke imbeshtetur vendet e Ballkanit Perëndimor drejt anëtarësimit përmes një sërë instrumentash.

★ **Instrumentet financiare përfshijnë:**

Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA III) – përbën mjetin kryesor të mbështetjes për periudhën 2021-2027 me një buxhet që kap shifrën e 14.61 miliardë euro. Përmes këtij instrumenti vendet candidate rrisin kapacitetet e tyre institucionale dhe administrative me qëllim arritjen

e standardeve të BE-së. Ky instrument përfshin një sërë programesh mbështetëse në të gjitha fushat e negociatave.


Instrumenti i mbështetjes së reformave dhe rritjes për Ballkanin Perëndimor 2024-2027- përbën një mbështetje ndryshe nga fondet IPA III, pasi përmes këtij mjeti BE-ka jep grante dhe kredi koncesionare për të përshpejtuar procesin e reformave socio-ekonomike dhe zhvillimit infrastrukturor për vendet kandidate. Në kuadër të këtij instrumenti fondet për shtetin kandidat jepen pasi të jenë përmbushur indikatorët e kontratës së lidhet mes tij dhe BE-së.

★ Integrimi ekonomik

Plani i Rritjes – është një instrument i cili synon të sjellë më afër disa nga përfitimet e anëtarësimit në BE, përpara se ky anëtarësim të ndodhë. Fokusohet në integrimin në tregun e përbashkët evropian dhe ka 7 prioritete për ti qasur vendet e Ballkanit në këtë treg.

Kuadri Investues për Ballkanin Perëndimor – është një platformë financiare e përbashkët e cila orienton fondet e BE-së dhe fondet e tjera ndërkombëtare drejt projekteve infrastrukturore, transportit, energjisë, digjitalizimit dhe kapitalit njerëzor.

Si funksionon procesi negociues?



1. Marrja e statusit të vendit kandidat - Shteti aplikon për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Pas vlerësimit nga Komisioni Evropian dhe miratimit nga Këshilli i BE-së, vendit i jepet statusi i kandidatit. Shqipëria e fitoi këtë status në vitin 2014.

2. Vendimi për hapjen e negociatave - Pas përmbushjes së kushteve të përcaktuara nga Komisioni Evropian, të cilat paraqiten në raportet e përvitshme të progresit që Komisioni për gatit për shtetin kandidat , Këshilli i BE-së vendos me unanimitet hapjen e negociatave. Shëpëria hapi negociatat në konferencën e parë ndërqeveritare (IGC), në korrik 2022.

3. Screening/Skanimi – pas hapjes së negociatave për anëtarësim, Komisioni Evropian analizon legjislacionin kombëtar dhe e krahason me *acquis* të BE-së. Në përfundim hartohen raportet e screening-ut dhe përcaktohen indikatorët që duhet të plotësohen për hapjen e secilit grupkapitull.

4. Shqyrtimi në COELA - Raportet screening dhe projekt propozimet e BE-së për arritjen e indikatorëve shqyrtohen në COELA, i cili është një grup teknik që punon pranë Këshillit dhe për gatit raportet për fazat e tjera të vendimarrjes. Më konkretisht, COELA është Grupi i Punës për Zgjerimin dhe Negociatat e Anëtarësimit në BE.

5. Miratimi në COREPER II – është miratimi paraprak që ambasadorët e shteteve anëtare bëjnë lidhur me pozicionin e përbashkët të BE-së përpara organizimit të

Konferencës Ndërqeveritare.

6. Konferenca Ndërqeveritare (IGC) – është konferenca që organizohet mes BE-së dhe vendit kandidat për hapjen ose mbylljen e grupkapitujve negociues.

7. Zbatimi i reformave – është hapi më i rëndësishëm përgjatë të cilit kandi kandidat ndërmerr reformat dhe përafron legjislacionin me atë të Bashkimit Evropian. Përgjatë këtij procesi vendi kandidat ka një bashkëpunim shumë të ngushtë me Komisionin Evropian, i cili monitoron të gjithë procesin dhe konfirmon progresin e arritur.

8. Mbyllja e përkohshme e kapitujve - Kur përmbushen indikatorët e vendosura nga BE-ja, kapitujt mbyllen përkohësisht deri në momentin e nënshkrimit të Traktatit, por mund të rihapen në rast se shteti kandidat bën regres.

9. Traktati i Anëtarësimit- Pas mbylljes së të gjithë kapitujve hartohet dhe nënshkruhet Traktati i Anëtarësimit, i cili ratifikohet nga Parlamentet e të gjitha shteteve anëtare dhe Parlamenti i shtetit kandidat. Natyrisht, duhet të ketë një unanimitet dhe vendim pozitiv me qëllim anëtarësimin e shtetit të ri.

10. Anëtarësimi në BE - Pas nënshkrimit të Traktatit të Anëtarësimit shteti kandidat bëhet anëtar me të drejta të plota në Bashkimin Evropian.

Ku ndodhet Shqipëria?

Pas Konferencës së Parë Ndërqeveritare në 2022 dhe ndërmarrjes së procesit të skanimit të të gjithë legjislacionit vendas nga Komisioni Evropian, Shqipëria ka nisur me çeljen e grupkapitujve negociues më 15 tetor 2024 [grupkapitulli 1] dhe dëri më 17 nëntor 2025 ka hapur negociatat për të gjithë grupkapitujt.


Komisioni Evropian vlerëson se Shqipëria ndodhet në një fazë të avancuar progresi drejt përmbushjes së detyrimeve të vendosura nga procesi negociues.

Pas përfundimit të të gjithë skanimit të legjislacionit dhe vendosjes së indikatorëve fillestarë për t'u përmbushur ku përfshihet ndryshimi dhe miratimi i një sërë ligjesh ekzistuese dhe të reja, Komisioni Evropian miratoi Raportin e Vlerësimit të Ndërmjetëm të Indikatorëve (IBAR) i cili paraqiti një vlerësim për të gjithë arritjet dhe sfidat e Shqipërisë në gjysëm të procesit negociues.

Në zbatim të metodologjisë aktuale të zgjerimit, Raporti IBAR përfshin një vlerësim të progresit lidhur me indikatorët fillestar vetëm lidhur me Grupkapitullin 1 "Themet", kapitujt e të cilit janë thelbësore për progresin e

mëtejshëm të procesit negociues. Gjithashtu, Raporti vendos dhe indikatorët që duhet të përmbushen për përmbylljen e negociatave.

Pas përgatitjes së Raportit, Komisioni e paraqiti atë në COELA për miratim, ku pas miratimit kaloi për miratim në COREPER II dhe më pas raporti i miratua në mënyrë unanime nga Këshilli i BE-së, i cili mori vendimin unanime në konferencën ndërqeveritare për përfundimin e fazës së parë dhe vendosjes së indikatorëve për fazën përfundimtare të negociatave.



Çfarë duhet të bëjë Shqipëria deri në 2027?

Bashkimi Evropian ka lënë një sërë detyrash për Shqipërinë me qëllim arritjen e progresit sipas afateve të parashikuara dhe përmbylljen e negociatave deri në përfundim të vitit 2027.

- » Pas vlerësimit të progresit të arritur nga reforma në drejtësi, BE-ja thekson se sistemi duhet të vazhdojë të konsolidojë pozitat e tij të pavarura dhe paanshmërinë ndaj ndërhyrjeve.
- » Gjithashtu, Shqipëria duhet të krijojë një “trak record” [historik] të qëndrueshëm lidhur me rezultatet në funksionimin e sistemit gjyqësor, luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, mbrojtjen e të drejtave themelore dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Të gjithë këto elementë janë të domosdoshëm për të arritur progres në këtë drejtim të Grupkapitullit 1.

- » Komisioni vëren nevojën për forcimin e dialogut politik dhe mbikëqyrjes parlamentare duke rritur më shumë transparencën e të gjithë veprimtarisë së institucioneve publike.
- » Shqipëria duhet të vijojë dhe të përfundojë harmonizimin dhe zbatimin e legjislacionit të BE-së (acquis) për të gjithë kapitujt negociues duke treguar ekzistencën e kapaciteteve të mjaftueshme administrative.
- » Për secilin kapitull negociues duhet të përmbushen indikatorët e vendosur nga Komisioni përpara mbylljes së tyre.
- » Element tepër i rëndësishëm për Shqipërinë në këtë fazë është pikërisht dhe forcimi i kapaciteteve të administratës publike për të zbatuar legjislacionin e përafruar tashmë, si dhe për të administruar fondet e BE-së. Gjithashtu, Shqipëria duhet të garantojë pasjen e një administrate publike që vepron mbi bazë të parimit të meritokracisë dhe është e depolitizuar.

